

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS, Departamenti për Krime të Rënda, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët: Fillim Skoro kryetar, Have Haliti dhe Tonka Berishaj , anëtarë, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtores profesionale, Kimete Veseli, si procesmbajtëse, në çështjen penale kundër të akuzuarit V.H. nga Prizreni, për shkak të veprës penale Blerja, posedimi shpërndarja dhe shitja e pa autorizuar e narkotikëve substancave psikotrope dhe analoge nga neni 273 par. 2 të KPRK-së, dhe veprës penale mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par. 2 të KP-së, duke vendosur sipas ankesës së Prokurorisë Themelore në Prizren PP.nr.220/16 dhe ankesës së të akuzuarit V.H., të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prizren, DKR PKR.nr.44/17, të datës 29.11.2017, në seancën e mbajtur konform dispozitës së nenit 390 të KPPK-së, me datën 27.03.2018, mori këtë:

A K T G J Y K I M

I. Me aprovimin ankesës së të akuzuarit V.H., ndryshohet aktgjykimi i Gjykatës Themelore-DKR në Prizren, DKR PKR.nr.44/17, i datës 29.11.2017, vetëm përkitazi me vendimin mbi dënim, për veprën penale Blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve të rrezikshëm dhe substancave psikotropike nga neni 273 par.2 të KPRK-së, ashtu që Gjykata e Apelit, e gjykon me dënim burgimi në kohëzgjatje prej 2 (dy) vjet, kurse dënimin me gjobë në shumë prej 1000 (një mijë) €, e merr si të vërtetuar, gjithashtu edhe për veprën penale mbajtje në pronësi, kontroll ose në posedim të pa autorizuar të armëve nga neni 374 par. 2 të KPRK-së, dënim burgimi në kohëzgjatje prej 2 (dy) vite, e merr si të vërtetuar, konformë nenit 80 të KPRK-së i shqipton dënim unik me burgim në kohëzgjatje prej 3(tre) vite, ku në dënimin me burgim i llogaritet edhe koha e kaluar në paraburgim dhe arrest shtëpiak nga data 01.09.2016 deri me 16.05.2017, nëse dënimin me gjobë në shumë prej 1000 (një mijë) €, nuk e paguan në afat prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit, dënimi me gjobë do të zëvendësohet me dënim me burg, ashtu që për çdo 20 € të dënimit me gjobë, do ti llogaritet një ditë burgim.

II. Ankesa e Prokurorisë Themelore DKR në Prizren, refuzohen si e pa bazuar.

III. Në pjesën tjetër aktgjykimi mbetet i pa ndryshuar.

A r s y e t i m

Gjykata Themelore në Prizren-DKR, me aktgjykimin PKR.nr.44/17 të datës 29.11.2017, të akuzuarin V.H., e ka shpallur fajtor për veprën penale Blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e pa autorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge nga neni par. 2 të KP-së, dhe për veprën penale mbajtje në pronësi, kontroll ose në posedim të pa autorizuar të armëve nga neni 374 par. 2 të KP-së, për veprën nën pikën e I të dispozitivit të aktgjykimit e ka gjykuar me dënim me burgim në kohëzgjatje prej 2 (dy) vite e 6 (gjashtë) muaj, si dhe dënim me gjobë në shumë prej 1000 (një mijë) €. Për veprën penale nën pikën II të dispozitivit të aktgjykimit e ka dënuar me dënim me burgim në kohëzgjatje prej 2 (dy) vitesh. Në kuptim të nenit 80 KPRK-së, të akuzuarit i është shqiptuar dënimi unik me burgim në kohëzgjatje prej 4 (katër) vitesh, në të cilin i është llogaritur edhe koha e kaluar në paraburgim dhe arrest shtëpiak nga data 01.09.2016 deri me 16.05.2017, si dhe dënim me gjobë në shumë prej 1000 (një mijë) €, të cilin dënim është i obliguar që ta paguaj në afat prej 15 ditëve pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit. Nëse i akuzuari nuk mund apo nuk dëshiron ta paguaj dënimin me gjobë, dënimi me gjobë do të zëvendësohet me dënim me burg, ashtu që për çdo 20 € të dënimit me gjobë do të llogaritet një ditë burgim.

Të akuzuarit i është shqiptuar edhe dënim plotësues, ashtu që i është konfiskuar substanca narkotike në peshë prej 672.69 gr, një revole e markës TT të kalibrit 7.62 mm, me numër serik 29545, 9 fishek të kalibrit 7.62mm, 32 fishek të kalibrit 9 mm, me mbishkrim PPU dhe 800 kapsolla ndezëse për eksploziv të vendosura në 8 kuti nga 100 copa, 44 kartë monedha me apoena prej 500€, një kartë monedhë prej 200€, 2 kartë monedha me apoena prej 50€, 4 kartë monedha me apoena prej 20€, 14 kartëmonedha prej 10€, si dhe 18 kartëmonedha me apoena prej 5€, 1 portofol me disa kartela bankare, 1 telefon i markës Iphone me numër të imëtit 359278066446310, një telefon të markës Samsung dhe një automjet të tipit “Jaguar” ngjyrë ari me targa 632-KS-122.

Të akuzuarin e ka obliguar, që ti paguaj të gjitha shpenzimet e procedurës penale sipas llogarisë së gjykatës, ndërsa në emër të paushallit gjyqësor shumë në lartësi prej 300 €, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh, pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

Kundër këtij aktgjykimi në afat ligjor ankesa kanë paraqitur:

Prokuroria Themelore-DKR në Prizren, për shkak të vendimit mbi dënimin, me propozim që aktgjykimi i ankimuar të ndryshohet, të akuzuarit ti shqiptohet dënim më i ashpër me burgim.

I akuzuari V.H., për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, shkeljes së ligjit penal, vërtetimi të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, vendimit mbi dënimin dhe konfiskimit të dobisë pasurore, me propozim që aktgjykimin e ankimuar ta anuloj dhe çështjen penale ta kthejë në rigjykim, ose që aktgjykimi i ankimuar të ndryshohet lidhur me cilësimin ligjor të veprës penale, të akuzuarit ti

shqiptoj një dënim më të ulët me burgim dhe me gjobë, ndërsa të hollat dhe automjeti i konfiskuar të i kthehen.

I akuzuari ka paraqitur përgjigje në ankesën e Prokurorisë Themelore-DKR në Prizren, dhe ka propozuar që të refuzohet ankesa e si e pa bazë.

Prokuroria e Apelit me parashtresën PPA/I.nr. 62/18 të datës 23.02.2018, ka propozuar që ankesa Prokurorisë Themelore-DKR në Prizren të aprovohet, aktgjykimi i ankimuar të ndryshohet sa i përket vendimit mbi dënimin, të akuzuarit ti shqiptohet dënim me burgim efektiv, ndërsa të refuzohet ankesa e të akuzuarit.

Gjykata e Apelit, konform nenit 390 par. 1 dhe 4 të KPPK-së, ka mbajtur seancën e kolegjit, prezent kanë qenë Prokuroria e Apelit, i akuzuari V.H. dhe mbrojtësi i tij av. H.K., me autorizim dhe përkthyesja e gjykatës Myzafere Halimi.

Gjykata e Apelit, ka shqyrtuar shkresat e lëndës, pretendimet ankimore të Prokurorisë Themelore-DKR në Prizren dhe të akuzuarit, aktgjykimin e ankimuar, dhe pas vlerësimit edhe të shkresave tjera të lëndës, gjeti se:

Ankesa e të akuzuarit V.H. është e bazuar vetëm sa i për ketë vendimit mbi dënimin me burgim, kurse ankesa e Prokurorisë Themelore-DKR në Prizren, është e pa bazuar.

I akuzuari V.H., në ankesë pretendon se aktgjykimi i ankimuar është përfshirë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, se dispozitivi i aktgjykimit është i paqartë, i pakuptueshëm dhe në kundërshtim me faktet vendimtare të cilat janë paraqitur ne arsyetimin e aktgjykimit. Aktgjykimi është përpiluar në kundërshtim me dispozitën e nenit 370 par. 4, 6 dhe 7 të KPRK-së, po ashtu gjykata në arsyetimin e aktgjykimit nuk i ka paraqitur në mënyrë të qartë dhe të plotë se cilat fakte i ka marrur si të vërtetuara në bazë të cilave të akuzuarin e ka shpallur fajtorë, gjykata nuk ka dhënë asnjë arsye se i akuzuari të këtë pasur marrëveshje me ndonjë person rreth shitjes apo çmimit për shitjen të substancave narkotike, edhe vepra penale mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të pa autorizuar të armëve, është bazuar në ekspertizën e ekspertit për armët, gjykata ka nxjerr konkludim të gabuar se 800 kapsollat e gjetura te i akuzuari nuk kanë qenë të gatshme për përdorim, se nuk kanë poseduar azot dhe gjykata nuk ka sqaruar se ato kapsulla a kanë qenë të rrezikshme, sepse ato janë gjetur në dhomën e gjumit të akuzuarit, si dhe nuk ka dhënë ndonjë sqarim lidhur me konfiskimin e shumës së të hollave të cilat janë marrë në shtëpinë e të akuzuarit, sepse i akuzuari të hollat në shumë prej 10.000 i ka huazuar në emër të kredisë së bashku me bashkëshorten e tij Kumrije Hoxhën, ndërsa nga motra e tij ka huazuar edhe 14.500 € për rregullimin e shtëpisë, po ashtu gjykata të akuzuarit ia ka konfiskuar edhe veturën e tipit “Jaguar” pa e sqaruar se a është përdorur kjo veturë për kryerjen e veprës penale për të cilën është shpallur fajtor.

Gjykata e Apelit, duke vlerësuar aktgjykimin e ankimuar sipas pretendimeve ankimore, por edhe sipas detyrës zyrtare, gjen se, aktgjykimi i ankimuar nuk është përfshirë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale dhe as shkelje të tjera të cilat kjo gjykatë i vëren sipas detyrës zyrtare, e që do të kushtëzonin anulimin e tij. Aktgjykimi i ankimuar është i qartë i kuptueshëm dhe përmban arsye të mjaftueshme mbi

të gjitha faktet vendimtare të kësaj çështje penale. Përkitazi me provat e administruara gjykata e shkallës së parë në arsyetimin e aktgjykimit ka dhënë arsye të mjaftueshme faktike dhe juridike që i aprovon edhe kjo gjykatë si të drejta dhe objektive, e që kanë mbështetje edhe në shkresat e lëndës. Nga shkresat e lëndës rezulton se substanca narkotike prej 672.69 gr. është gjetur në shtëpinë e tij, kurse në veturën e tij të tipit "Jaguar", është gjetur një sasi e marihuanës në peshë prej 0,27 gr, si dhe bunkeri i punuar në veturë për transportimin e substancës narkotike, kurse policia gjatë bastisjes se shtëpisë se tij ka gjetur një revole të tipit TT të kalibrit 7.62 mm, me numër serik 29545, 9 fishek të kalibrit 7.62mm, 32 fishek të kalibrit 9 mm, me mbishkrim PPU dhe 800 kapsolla ndezëse për eksploziv të vendosura në 8 kuti nga 100 copa, si dhe 44 kartë monedha prej 500€, një kartë monedhë prej 200€, 2 kartë monedha prej 50€, 4 kartë monedha prej 20€, 14 kartëmonedha prej 10€, si dhe 18 kartëmonedha prej 5€, të cilat janë konfiskuar, ashtu që gjykata e shkallës së parë drejtë ka vlerësuar provat materiale që mbështesin aktakuzën, se i akuzuari është kryes i veprës penale dhe në veprimet e tij formohen të gjitha elementet e veprave penale për të cilat e ka shpallur fajtor. Nga kjo rezulton aktgjykimi i ankimuar nuk është përfshirë në shkeljet esenciale të procedurës penale të pretenduara në ankesa.

I akuzuari pretendon se me aktgjykimin e ankimuar gabimisht është vërtetuar gjendja faktike, se me provat që janë administruar nuk vërtetohet fakti se kemi të bëjmë me veprat penale për të cilat është shpallur fajtor, se nuk është kontestuese se në shtëpinë e tij është gjetur sasia e marihuanës 672.69 gr, po ashtu është gjetur edhe një revole e tipit TT të kalibrit 9mm, 9 fishek të kalibrit 7.62 mm 32 fishekë të kalibrit 9 mm, si dhe 800 kapsolla ndezëse për eksploziv të vendosura në 8 kuti nga 100 copë, por është kontestuese se a ka pasur marrëveshje i akuzuari me ndonjë person për shitjen e substancës narkotike, se kapsullat të cilat janë gjetur ju ka munguar azoti si pjesë përbërëse kapsullave, nuk është vërtetuar se a kanë qenë në funksion dhe a kanë paraqitur rrezikshmëri, ashtu që gjykata e shkallës së parë nuk ka dhënë arsye se si e ka vërtetuar gjendjen faktike lidhur me veprën penale, posedim, shpërndarje dhe shitje e paautorizuar të substancave narkotike dhe analoge nga neni 273 par. 2 të KPRK-së, dhe veprën penale mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par. 2 të KPRK-së.

Kjo gjykatë vlerëson, se Gjykata e shkallës së parë në mënyrë të drejtë dhe të plotë ka vërtetuar gjendjen faktike kur ka gjetur, se i akuzuari V.H. me datë 01.09.2016, me veturën e tij të tipit "Jaguar" me tabela të regjistrimit 632-KS -122 , e ka transportuar në shtëpinë e tij substancën narkotike të llojit "Marihuanë", me qëllim të shitjes, se ka biseduar telefon me një person me emrin E. ashtu që gjatë bastisjes së shtëpisë se tij nga ana e policisë i është gjetur sasia e marihuanës në peshë prej 672.69 gr, kurse në bunkerin e ndërtuar në veturë është gjetur edhe një sasi me peshë prej 0,27 gr, që vërteton faktin se i akuzuari ka transportuar substancën narkotike me veturë. E kjo vërtetohet edhe nga masat e fshehta të vëzhgimit, për të cilën kishte lëshuar urdhëresë gjykata, sepse Njësia e DHTN, kanë pasur informacion se i akuzuari po merret me shitjen e substancës narkotike, si dhe fotodokumentacioni mbi vendodhjen e substancës me rastin e konfiskimi. Gjithashtu edhe gjatë bastisjes së shtëpisë së tij nga ana e policisë, i janë konfiskuar një revole e tipit TT të kalibrit 9mm, 9 fishek të kalibrit 7.62 mm 32 fishekë të

kalibrit 9 mm, si dhe 800 kapsolla ndezëse për eksploziv të vendosura në 8 kuti nga 100 copë, si dhe një shumë e të hollave.

Këtë gjendje faktike, gjykata e shkallës së parë e ka vërtetuar nga raporti i ekspertizës së bërë nga Njësia e Shkencave Ligjore për llojin dhe sasinë substancës narkotike, vërtetimit mbi konfiskimin e substancës narkotike dhe të armëve, raportit të ekspertizës së Agjencionit të Forenzikës ku është bërë ekzaminimi i tre telefonave të konfiskuar nga i akuzuari, sepse gjatë bisedave të zhvilluara, i akuzuari kishte biseduar përmes Viber-it me persona të ndryshëm për blerjen, transportimin dhe shtijen e substancës narkotikeve të llojit marihuanë në Gjermani, Slloveni dhe vende të tjera, ku përmes nr. të telefonit xxx kishte biseduar me një person në Gjermani në nr.e telefonit +xxx, të cilin e njofton për dërgesën duke i thënë se "është i lagur dhe duhet të terët" kurse bashkëbiseduesi i përgjigjet " që të bëjë një vend të sigurt në automjet", pastaj nga transkriptet e bisedave telefonike të cilat janë përgjuar me masa të fshehta gjatë muajit korrik të viti 2016, është vërtetuar se i akuzuari ka biseduar me një person të quajtur E. nga Mitrovica, gjoja për kamion duke i thënë "pyete personin me emrin Çaki, apo dikë tjetër në Kroaci se sa po sillet çmimi", kurse E.i ia kthen "në Kroaci çmimi sillet prej 2800 deri 3500", nga këto biseda vërtetohet se bëhet fjalë për substancë narkotike, kurse termi "kamion" përdoret si pseudonim, sepse nuk ka prova se i akuzuari është marrur me shitblerjen e automjeteve.

Se nuk është kontestuese se nga Drejtorisë e Teknikës Kriminallistike është bërë ekzaminimi i veturës së tipit "Jaguar", ku në bagazhin e veturës ka qënë i vendosur bunker, me dimension 0,86 cm, gjatësi, gjersi 0,35 cm, dhe i thellësi 20 cm, ku në këtë brendi është gjetur edhe substanca narkotike në peshë 0,27 gr.dhe e njehta veturë është përdorur për transportimin e substancës narkotike që është gjetur në shtëpi, e që vërtetohet edhe nga fotodokumentacioni mbi vendndodhjen e substacës me rastin e konfiskimit.

Nuk është kontestuese, se sipas mendimit të ekspertit B.H. kapsullat ndezëse të konfiskuar në shtëpinë e të akuzuarit, 8 kuti me nga 100 copë kapsulla, përdoren vetëm nga personat e autorizuar të forcave të armatosura dhe në polici, pesonat privat nuk guxojnë të posedojnë këta lloj detonatorësh, kurse në fushat civile nuk përdoren fare dhe janë mjete të rrezikshme, sipas ekspertit, prodhues i këtyre detonatorve është Shqipëria dhe nuk shiten as në lokalet e specializuar të armëve për shkak të rrezikshmërisë, e nuk qëndrojnë pretendimet e të akuzuarit se kapsullave ju ka munguar azoti si pjesë përbërëse dhe nuk kanë qënë në funksion.

Kurse sa ju përketë të hollave të cilat janë konfiskuar nga ana e gjykatës së shkallës së parë, si mjete të përfituara me kryerjen e veprës penale, e që i akuzuari pretendon se gjykata se shkallës së parë nuk ka dhënë arsyet e mjaftueshme se këto të holla janë fituar me veprën penale, se i akuzuari të hollat në shumë prej 10.000 €, i ka huazuar nga Raiffeisen Bank për rregullimin e shtëpisë, kurse 14.500 nga motra e tij, nuk qëndrojnë.

Nuk është kontestuese se i akuzuari në muajin prill të vitin 2016, e ka marrur një kredi Raiffeisen Bank në shumë prej 10.000 €, ku si bashkëhuamarëse ka qënë bashkëshortja e tij, K.H., por tërheqja e kredisë është bërë në shuma të ndryshme, pjesë

pjesë, e cila kredi është marrur për renovimin e lokalit, kurse dëshmitarja K.H.j-bashkëshortja e të akuzuarit dhe i akuzuari, kanë deklaruar se kredinë e kanë marrë për ndërtimin e shtëpisë, kurse shumën e të hollave prej 14.500 € gjoja se e ka marrë nga motra e tij Sh.P. e cila jeton në Gjermani, këtë fakt nuk e kanë argumentuar me asnjë provë materiale.

Se nuk është kontestuese se i akuzuari V.H., ditën kritike ka qenë nën masat e vëzhgimit, deri sa substancën narkotike e ka transportuar me veturë në shtëpinë e tij, kur policia e ka bastisur veturën e tipit “Jaguar” e ka gjetur një bunker dhe një sasi të substancës narkotike prej 0.27 gr. Andaj, duke i pasur parasysh të gjitha rrethat e cekura më lartë, si dhe arsyet e theksuara në arsyetimin e aktgjykimit të ankimuar, Gjykatata e Apelit vlerëson se gjykata e shkallës së parë, në mënyrë të drejtë dhe të plotë ka vërtetuar gjendjen faktike, duke bërë vlerësimin dhe analizën e provave të administraura, ka nxjerr konkludime të drejta dhe të ligjshme të cilat i ka arsyetuar, për të gjitha faktet relevante, për të cilat e ka shpallur fajtor.

I akuzuari pretendon se si pasojë e shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike për të dy veprat penale është shkelur ligji penal në dëm të akuzuarit sipas nenin 385 par. 1 nën par. 1.4 të KPRK-së. Se në veprimet e të akuzuarit për të dy veprat penale përmbushen elementet e veprave nenin 273 par. 1, si dhe neni 374 par. 1 të KPRK-së.

Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, gjykata e shkallës së parë drejt ka zbatuar ligjin penal, kur ka gjetur se në veprimet e të akuzuarit ekzistojnë elementet e veprës penale, blerja, posedimi shpërndarja dhe shitja e pa autorizuar e narkotikëve substancave psikotropike dhe analoge nga neni 273 par. 2 të KPRK-së, se në veturën e të akuzuarit është gjetur bunkeri i punuar, e që është përdore për shitjen dhe shpërndarje e substancës narkotike, kurse të vepra penale mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par. 2 të KPRK-së, se nëse i akuzuari posedon më shumë se 400 fishekë, e që në rastin konkret të i akuzuari janë gjetur 800 fishekë, andaj pretendimet ankimore të akuzuarit, se është shkelur ligji penal në dëm të tij, janë të pa bazuara, se me provat e administruara është vërtetuar në mënyrë të pa dyshimtë fajësia e të akuzuarit për këto vepra penale.

I akuzuari thekson se gjykata e shkallës së parë me rastin e shqiptimi të dënimit ka marrur parasysh, si rrethana lehtësuese, se është penduar, gjendjen e vështirë ekonomike, më parë nuk ka qenë i dënuar, përkundër se i ka cekur rrethanat lehtësuese dhe nuk gjetur fare rrethana rënduese, prapë i ka shpallur dënim unik me kohëzgjatje prej 4 viteve si dhe dënim me gjobë në shumë prej 1.000 €, pa i vlerësuar drejtë rrethanat lehtësuese duke i shqiptuar një dënim komulativ shumë të lartë. Ka propozuar që të akuzuarit ti kthehen sendet e konfiskuara, të hollat në shumën e cekur më lartë dhe vetura, të akuzuarit ti shqiptoj dënim me gjobë dhe burgim më të ulët.

Prokuroria në ankesë, pretendon se dënimi i shqiptuar të akuzuarit është i ulët dhe nuk është në proporcion me shkallën e përgjegjesisë penale dhe shkallën e rrezikshmërisë shoqërore dhe pasojës se shkaktuar nga veprat penale, se i akuzuari nuk e ka pranuar fajësinë, se gjykata nuk i ka vlerësuar drejtë rrethanat rënduese, sipas nenit 73 të KPRK-së, me një dënim të tillë nuk mund të arrihet qëllimi i dënimit dhe të ndikoj si preventivë

që veprat e tilla në të ardhmen mos të kryhen nga i akuzuari dhe të tjerët, ka propozuar të i shqiptohet dënimi me i ashpër.

Gjykata e shkallës së parë me rastin e caktimit të llojit dhe lartësisë së dënimit ka pasur parasysh rrethanat lehtësuese dhe rënduese, kështu që të akuzuarit, si rrethana lehtësuese i ka marrë për bazë sjelljen korrekt pas kryerjes së veprës penale, se është përnduar, gjendjen e dobët ekonomike, më parë nuk ka qenë i dënuar, kurse si rrethana rënduese, peshën e veprës penale, pasojat që kanë mund të shkaktohen nga substanca narkotike dhe dhe detonatorët që i ka poseduar.

Sipas vlerësimit të Gjykatës Apelit, gjykata e shkallës së parë drejtë i ka konstatuar dhe vlerësuar të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese që ndikojnë, në caktimin e llojit dhe lartësisë së dënimit konform nenit 73 të KPRK-së, si rrethana lehtësuese ka marrë parasysh, se i akuzuari është familjar, baba i dy fëmijëve, i gjendjes dobët ekonomike, ka pasur sjellje korrekte pas kryerjes së veprës penale, se është përnduar, kurse si rrethanë rënduese gjykata ka marrë për bazë peshën e veprës penale, pasojat që kanë mund të shkaktohen nga substanca narkotike dhe detonatorët që i ka poseduar. Vlerësimet e këtilla të rrethanave relevante për matjen e dënimit, i pranon edhe kjo gjykatë dhe gjen se në pranimin e rrethanave lehtësuese të aplikuar nga gjykata e shkallës së parë, ka vend për shqiptimin e dënimit më të butë, duke pasur parasysh faktin se më parë nuk ka qenë, edhe pse nuk e ka pranuar fajësinë e ndien vetën përgjegjës për gjërat që i janë gjetur në shtëpi, ka kuptuar pasojat e veprimit të tij. Prandaj duke pasur parasysh të gjitha rrethanat e lartë cekura në aktgjykimin e ankimuar, rrethanat e rastit konkret kontinuitetin e veprimtarisë inkriminuese të të akuzuarit, del se dënimi i shqiptuar si në dispozitivin të aktgjykimit është në harmoni me intensitetin e rrezikshmërisë shoqërore të veprës së kryer penale, shkallën e përgjegjësisë penale të akuzuarit, është në funksion të preventivës gjenerale dhe të asaj individuale, se me dënimin e shqiptuar si në dispozitivin të këtij aktgjykimit, do të arrihet qëllimi i dënimit i paraparë me dispozita të nenit 41 të KPRK-së.

Prandaj, nga arsyet e sipër cekura u vendos si në dispozitivin të këtij aktgjykimi e konform nenit 403 të KPPK-së.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS

PAKR.nr.59/2018 me 27.03.2018

Procesmbajtësja,

Anëtarët e kolegjit,

Kryetari i kolegjit,

Kimete Veseli,_____

Have Halitit,_____

Fillim Skoro

Tonka Berishaj,_____